

VENDIM
Nr. 230, datë 17.4.2019

**PËR SHPALLJEN, KATEGORIZIMIN DHE EMËRTIMIN E PORTIT
TË LLOJIT MBM, NË PORTO-ROMANO, DURRËS, “PORT I HAPUR
PËR TRAFIK NDËRKOMBËTAR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 18, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen, kategorizimin dhe emërtimin e portit detar të llojit MBM (*Multi Buoy Mooring*), në Porto-Romano, Durrës, si “Port i hapur për trafik ndërkombëtar”, i cili i ka specifikat, si më poshtë vijon:

a) Koordinatat gjeografike	Pika A: N- 41° 22'18.532" E- 19 °23'31.052" Pika B: N- 41° 21'48.277" E- 19 °23'46.517" Pika C: N- 41°21'36.625" E- 19 °23'6.361" Pika D: N- 41°22'6.877" E- 19 °22'50.891" Pika P1: N- 41°22'32.520" E- 19°25'19.200"
b) Veprimtaria detare	Ngarkim-shkarkim i naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre;
c) Operativiteti	Port i hapur për trafik ndërkombëtar, 24 orë;
ç) Shfrytëzimi	Faza I: Sipas marrëveshjes koncesionare gjatë kohëzgjatjes së koncesionit miratuar me ligjin nr. 104/2015; Faza II: Pronë e shtetit shqiptar dhe e lirë për t'u shfrytëzuar sipas vullnetit të shtetit, pas përfundimit të koncesionit;
d) Menaxhimi	Faza I: Shoqëria koncesionare “Porti MBM (<i>Multi Buoy Mooring</i>)” sipas marrëveshjes koncesionare miratuar me ligjin nr. 104/2015, gjatë kohëzgjatjes së koncesionit; Faza II: Shteti shqiptar, përfaqësuar nga organet qendrore përgjegjëse, në fushën e porteve dhe zhvillimit ekonomik;
dh) Pronësia	Shteti shqiptar, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave. Kufizime: Në përdorim të shoqërisë koncesionare “Porti MBM (<i>Multi Buoy Mooring</i>)” Porto Romano, Durrës, gjatë kohëzgjatjes së koncesionit;
e) Marrëdhënia me institucionet përgjegjëse për transportin dhe energjinë	Raportim periodik për vëllimin e punës së kryer në port;
ë) Detyrime të tjera	Person kontakti dhe adresë kontakti në çdo kohë. Faqe zyrtare në gjuhën shqipe dhe në anglisht që përmban informacion të plotë për rregullat e funksionimit të portit, tarifatat dhe normat ditore të ngarkim-shkarkimit, si dhe informacion për situatën e anijeve në port.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, të marrin masa që në bashkëpunim me drejtuesit e portit të bëjnë funksionale të gjitha strukturat

përkatëse shtetërore, përfshirë komunikimin nominal të personave që do t'i ushtrojnë këto funksione në port.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe